

VENDIM
Nr.6, datë 26.1.2007

**PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR TË
LICENCUARIT PËR PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HIDROCENTRALET ME
FUQI TË INSTALUAR DERI NË 10 MW PËR VITIN 2007**

Në mbështetje të neneve 9, 26, 27 dhe 28 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, në vendimin nr.6, datë 26.1.2007 “Për miratimin e metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike për të licencuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC-et me fuqi të instaluar deri në 10 MW”, Bordi Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.1.2007, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Departamenti i Tarifave dhe Çmimeve për përcaktimin e çmimeve të shitjes së energjisë elektrike për të licencuarit, për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet me fuqi të instaluar deri në 10 MW, për vitin 2007,

VENDOSI:

1. Çmimi unik i shitjes së energjisë elektrike për të licencuarit, për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet me fuqi të instaluar deri në 10 MW, për vitin 2007, është 6.2 lekë/kWh.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta